# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6628
E hënë, 13 qershor 2022
çmimi 0.40


## Diçka për çlirimin, për strategët dhe për budallenjtë e Stanit

FAQE 3

Nga: Muhamet MAVRAJ




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KOSOVA SHËNOI 23-VJETORIN E HYRJES SË TRUPAVE TË KFOR-it

# KOSOVA SHËNOI DITËN E ÇLIRIMIT, FALËNDERUES PËRJETËSISHT NATO-s E SHBA-së

FAQE 4-5




Me një varg ceremonish është shënuar dita kur në Kosovë qenë futur për herë të parë ushtarët e NATO-s më 12 qershor 1999. Hyrja e trupave të misionit të NATO-s, KFOR, i dha fund luftës gati dyvjeçare. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se 23 vjet më parë këtu shumë kosovarë u kthyen në shtëpi. "NATO solli stabilitet dhe prosperitet për Kosovën dhe rajonin", ka thënë ambasadori amerikan

## "Open Balkan", mollë sherri për shqiptarët

FAQE 5






## OSMANI NË SAMITIN E SEECP-së: BE-ja URGJENTISHT T'I LIBERALIZOJË VIZAT PËR KOSOVËN

FAQE 3

## AKTUALE



### NUMRI I REFUGJATËVE UKRAINAS NË POLONI KALON 4 MILIONË

F. 2

### SPANJA PËRBALLET ME TEMPERATURA DERI NË 43 GRADË CELSIUS

F. 2

### HOVENIER TAKON GRUAN SIMBOL TË EKSODIT TË KOSOVËS: SHERIFJA, FYTYRA E NJË LUFTE BRUTALE

F. 5




## EKONOMI



### A ËSHTË STRATEGJIA E RE ZGJIDHJE PËR KRIZËN ENERGJETIKE?

F. 6

## SPORT

### KOSOVA PËSON HUMBJE NË NDESHJEN E TENSIONUAR NDAJ GREQISË

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Spanja përballet me temperatura deri në 43 gradë celsius

**Madrid, 12 qershor** - Shërbimi i motit i Spanjës thotë se një masë e ajrit të nxehtë nga Afrika e Veriut solli të dielën valën e parë të madhe të të nxehtit në këtë shtet, me temperatura që priten të arrijnë deri në 43 gradë celsius.
Agjencia e motit "Aemet" tha se zonat më të nxehta do të jenë në Spanjën qendrore dhe jugperëndimore.
Vala e të nxehtit pritet të zgjasë të paktën deri të mërkurën, tha agjencia.
Moti 43 gradë ishte parashikuar për qytetet jugore të Seviljes, Kordobës dhe Badajozit.
Meteorologët thanë se temperatura në Madrid mund të arrijë 38 gradë celsius, shumë mbi mesataren në fillim të qershorit.
Temperatura më e lartë e parashikuar në Barcelonën bregdetare ishte 32 gradë celsius.



# BE-ja përballet me një vendim 'historik' për anëtarësimin e Ukrainës

**Bruksel, 12 qershor** - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, thotë se vendet anëtare përballen me një "vendim historik: në një samit që do të mbahet më 23 dhe 24 qershor, në të cilin do të vendoset nëse do t'i japin Ukrainës statusin e anëtarësimit. "Shpresoj pas 20 vjetësh, kur të shikojmë prapa, ne do të jemi në gjendje të themi se bëmë gjënë e duhur", u tha Von der Leyen gazetarëve gjatë kthimit nga një vizitë në Kiev.
Von der Leyen kishte udhëtuar të shtunën në Kiev për të diskutuar me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, ndër të tjera, për pikat e mbetura në aplikimin e Ukrainës për anëtarësim, raporton DPA.
Ekzekutivi i BE-së dëshiron ta publikojë rekomandimin e tij në fund të javës nëse vendit, i cili i ka rezistuar një pushtimi rus që nga 24 shkurti, duhet t'i jepet statusi i kandidatit për anëtarësim në BE.
Ukraina ka arritur shumë në vitet e fundit, por mbetet shumë për të bërë, tha Von der Leyen në rrugën e saj gjatë kthimit në Poloni. "Rekomandimi ynë do ta pasqyrojë me kujdes këtë", shtoi ajo.



# Rusia zëvendëson rrjetin e ushqimeve të shpejta 'McDonald's'

**Moskë, 12 qershor** - Pas tërheqjes së rrjetit amerikan të ushqimit të shpejtë 'McDonald's', në Rusi është hapur një rrjet i ri që mëton ta zëvendësojë kompaninë amerikane.
Rrjeti i ri i dyqaneve të ushqimit të shpejtë në Rusi mban porosinë "E shijshme dhe kaq".
Pronarët e rrjetit të ri, emri i të cilëve në rusisht është "Vkusno" dhe "Tochka", thonë se fillimisht 15 restorante të riemërtuara do të rihapen në të gjithë Rusinë, me të tjera që do të vijnë në muajt e ardhshëm.
Dhjetëra rusë u rreshtuan më 12 qershor në një vend të famshëm të Moskës ku




"McDonald's" hapi për herë të parë dyert 30 vjet më parë.
Oleg Paroev, shefi ekzekutiv i kompanisë që mori përsipër objektet e "McDonald's", tha se ata planifikojnë të rihapin 200 restorante në Rusi deri në fund të qershorit dhe të gjitha 850 lokalet në mbarë vendin deri në fund të verës. "Qëllimi ynë është që mysafirët tanë të mos vërejnë dallime as në cilësi dhe as në ambient", citohet të ketë thënë Paroev në një konferencë për shtyp.
Paroev tha se rrjeti i ri do ta ruajë brendësinë e tij të vjetër të "McDonald's", por do të heqë çdo referencë për emrin e tij të vjetër.
Rihapja e pikave të ushqimit të shpejtë shihet si një test nëse dhe si ekonomia e Rusisë mund t'u rezistojë sanksioneve perëndimore të vendosura pasi Rusia pushtoi Ukrainën më 24 shkurt.
Në kohën e tërheqjes së saj nga Rusia, "McDonald's" tha se punësonte 62 mijë punëtorë në të gjithë Rusinë.
"McDonald's" ishte ndër kompanitë e para që u tërhoq nga Rusia pas pushtimit rus të Ukrainës. Njëjtë vepruan edhe shumë kompani të mëdha botërore.

## Numri i refugjatëve ukrainas në Poloni kalon 4 milionë

**Varshavë, 12 qershor** - Numri i ukrainasve që janë larguar nga vendi i tyre për në Poloni që nga pushtimi i Rusisë ka kaluar shifrën 4 milionë, sipas agjencisë polake të patrullimit kufitar. Kjo agjenci e ka bërë publike këtë shifër të dielën përmes një postimi në "Twitter".
Të dhënat më të fundit tregojnë se 24 900 njerëz kanë mbërritur në Poloni të shtunën më 11 qershor. Megjithatë, është e pamundur të thuhet se sa nga ata njerëz kanë qëndruar në Poloni dhe sa kanë udhëtuar më tej në vende të tjera të Evropës Perëndimore.
Presidenti polak Mateusz Morawiecki kohët e fundit tha se vendi i tij po strehon rreth 2 milionë refugjatë ukrainas.
Autoritetet polake të shtunën vunë në dukje se 28 000 njerëz po largoheshin nga Polonia, shumë prej të cilëve u kthyen në zonat që janë rikthyer nën kontrollin e Ukrainës.
Ukraina kishte një popullsi prej më shumë se 44 milionë qytetarësh para pushtimit.
Shumë nga ata që ikën u drejtuan për në Poloni, e cila ndan një kufi 500 kilometra të gjatë me Ukrainën.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Diçka për çlirimin, për strategët dhe për budallenjtë e Stanit



Nga: Muhamet MAVRAJ

Qershori, sikur Nëntori e ky sikur shkurti. Kemi shumë data historike në këta muaj, por edhe në të tjerët. Vështirë të ketë më të rëndësishme diçka në jetë për njeriun normal sesa Çlirimi.

Përtej retorikave patetike, në themele mbesin disa fakte të pakontestueshme.

Çlirimtarët e Kosovës bartën mbi supe tjetër fat nga ata të kombeve të tjera, përfshirë këta sot përballë rusëve.

Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nuk janë "luftëtarë të dalluar" dhe as nuk është lider a njeri "historik" cilido që mallkoi luftën e tyre. Përtej "luftëtarëve të dalluar", ata janë strategë të lirisë, sepse ata dhe gjeneratat inspiruese të tyre dhe përkrahësit e tyre kishin më shumë detyra sesa çlirimtarët e kombeve të tjera:

1. Të rezistonin në mënyrat që u kushtonin me lëçitje, burgje dhe vrasje me torturë ose me plumb;
2. Nga asgjëja t'i krijonin celulat e para të armatosura e tutje lidhjen e tyre në Ushtri Çlirimtare;
3. Ta çlironin vendin duke dalë mijëra herë përballë vdekjes;
4. T'i krijonin kushtet për shpalljen e shtetit;
5. Ta shpallnin shtetin dhe ta afirmonin atë;
6. Ta duronin poshtërimin e burgjet e tjera pas gjithë këtyre kryeveprave, siç ndodhi e po ndodh sistematikisht.

Nuk kemi pasur, nuk kemi dhe as mund të kemi strehë e besë më të fortë sesa Shqipërinë e Shtetet e Bashkuara. Sjelljet abuzuese të kujtdo, veçanërisht nga krerët e vendit, sistematikisht, ndaj këtyre dy shtyllave të shtetësisë sonë dhe ndaj luftëtarëve të lirisë e dëshmorëve të kombit, nuk janë çmenduri, por vetëdije për izolimin e Kosovës thellë në errësirë.

Ka Kosova djem sërish!

Lavdi heronjve të gjallë e të ikur!

# Osmani në Samitin e SEECP-së: BE-ja urgjentisht t'i liberalizojë vizat për Kosovën

Prishtinë, 12 qershor (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në Samitin e krerëve të shteteve të Evropës Juglindore ka folur për rolin e Republikës së Kosovës në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në rajon, rëndësinë e bashkëpunimit bazuar në parimin e barabarësisë dhe gjithëpërfshirjes, si dhe për nevojën për ta përshpejtuar perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe vendeve të tjera demokratike të rajonit.

Në fjalimin e saj gjatë Samitit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), presidentja Osmani ka nënvizuar përparimin e Kosovës në zbatimin e reformave që kanë fuqizuar cilësinë e demokracisë dhe sundimin e ligjit.

Më pas presidentja është ndalur edhe tek agresioni ilegal dhe lufta e paprovokuar e Rusisë kundër Ukrainës dhe ka theksuar se e drejta e kombeve për të ekzistuar dhe për të qenë sovran ndodhet nën kërcënim. "Përballë agresionit të Putinit kundër Ukrainës, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos i hapim dyert çfarëdo ndikimi keqdashës në rajonin tonë", ka theksuar Osmani, duke nënvizuar se shtetet e rajonit duhet të kenë qëndrim unik në ndalimin e tendencave të Rusisë për destabilizimin e rajonit dhe në miratimin e sanksioneve kundër Rusisë.

Më tej, presidentja Osmani para krerëve të shteteve pjesëmarrëse ka përsëritur domosdoshmërinë e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. "Qasja në institucionet dhe mekanizmat e Këshillit të Evropës, siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është mbi të gjitha në interes të qytetarëve të Kosovës, të të gjitha përkatësive etnike, fetare apo të tjera. T'i thuash jo anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës është t'u thuash jo të drejtave të njeriut për qytetarët tanë", ka thënë presidentja Osmani. Në këtë kuadër, ajo ka përmendur përjashtimin e padrejtë të Kosovës nga procesi i liberalizimit të vizave. "Disa nga mendjet tona më të ndritura, nga studentët e deri te doktorantët, studiuesit apo gazetarët hulumtues, humbasin ditën e tyre të orientimit, ditën e diplomimit, mbrojtjen e doktoratës ose një ngjarje me rëndësi profesionale për shkak të mungesës së vizës, për shkak të ngarkesës së ambasadave ose për shkak të mungesës së mundësisë për ta rezervuar termin për aplikim për vizë", ka theksuar Osmani, duke e cilësuar këtë si një padrejtësi për popullin e Kosovës dhe duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian që urgjentisht t'i liberalizojë vizat për vendin tonë.

Në darkën e përbashkët me kancelarin Scholz, presidentja Osmani e falënderoi kancelarin për mbështetjen e madhe të Gjermanisë si dhe për qëndrimet e qarta të qeverisë së tij për të ardhmen euroatlantike të vendit tonë. Në anën tjetër, kancelari Scholz potencoi rëndësinë e përshpejtimit të procesit të anëtarësimit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe fuqizimin e Procesit të Berlinit.

Gjatë Samitit të vendeve të Evropës Juglindore, Osmani ka realizuar takime me presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor dhe kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviq.

Presidentja Osmani ka falënderuar Slloveninë dhe Kroacinë për mbështetjen e dhënë për integrimin euroatlantik të Kosovës, ndërkaq ka diskutuar për përkrahjen e këtyre shteteve në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Përgjatë samitit, presidentja Osmani bashkëbisedoi edhe me kryetarin e Këshillit të BE-së, Charles Michel, kryesuesin e Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës Sefik Dzaferoviq, kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski dhe kryeministren e Moldavisë, Natalia Gavrilia. Në këto takime Osmani theksoi nevojën për përshpejtimin e integrimit të shteteve të rajonit në institucionet euro-atlantike dhe në fusha të tjera të interesit të përbashkët.






KOSOVA SHËNOI 23-VJETORIN E HYRJES SË TRUPAVE TË KFOR-IT

# Kosova shënoi Ditën e Çlirimit, falënderues përjetësisht NATO-s e ShBA-së

Me një varg ceremonish është shënuar dita kur në Kosovë qenë futur për herë të parë ushtarët e NATO-s, më 12 qershor 1999. Hyrja e trupave të misionit të NATO-s, KFOR, i dha fund luftës gati dyvjeçare. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se 23 vjet më parë këtu shumë kosovarë u kthyen në shtëpi. “NATO solli stabilitet dhe prosperitet për Kosovën dhe rajonin”, ka thënë ambasadori amerikan

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kosova ka shënuar të dielën 23-vjetorin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Më 12 qershor 1999 trupat e para të misionit të NATO-s, KFOR, u futën në territorin e Kosovës, duke i dhënë kështu fund një lufte gati dyvjeçare.

Një varg aktivitetesh u zhvilluan në Kosovë, përfshirë homazhe te varrezat e dëshmorëve si dhe ceremoni të tjera në të cilat morën pjesë zyrtarët e shtetit të Kosovës.

Në Bllacë, në pikën kufitare në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se futja e trupave të NATO-s në Kosovë i kishte dhënë fund vrasjes dhe dëbimit të shqiptarëve.

Ajo tha se Kosova ka ndërtuar miqësi me ShBA-në dhe shtetet anëtare të NATO-s të cilat kontribuuan për çlirimin dhe bërjen shtet të Kosovës. “Kosova ka bërë hapa përmbajtjesorë drejt të ardhmes euroatlantike, duke qenë një shtet i dominuar nga rinia. Përpjekja jonë e vazhdueshme është që Kosovën ta shndërrojmë në vend ku ata e krijojnë dhe kanë perspektivën e tyre. Këtë po e bëjmë çdo ditë. Potenciali i rinisë kosovare është i jashtëzakonshëm, andaj saj duhet t’i jepet dhe t’i krijohet mundësia”, theksoi presidentja Osmani.

Ndërsa kryeministri i Kosovës Albin Kurti, tha se Qeveria e Kosovës po punon për adresimin e së kaluarës dhe krimeve të kryera nga Serbia në Kosovë.

Në ceremoni ishte edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i cili, pas ceremonisë që u zhvillua në Bllacë të Hanit të Elezit, shkroi në “Twitter” se trupat e KFOR-it sollën paqen në Kosovë. “I nderuar që festova sot Ditën e Paqes në kufirin e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, përkrah zyrtarëve të Kosovës dhe anëtarëve të komunitetit diplomatik. 23 vjet më parë këtu shumë kosovarë u kthyen në shtëpi. NATO solli stabilitet dhe prosperitet për Kosovën dhe rajonin”, ka shkruar Hovenier.

23 vjet më parë, më 12 qershor 1999, forcat e NATO-s hynë në Kosovë. Paraprakisht kishin nisur bombardimet e NATO-s që zgjatën 78 ditë. Pas sulmeve ajrore bombardimet u ndërprenë më 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe trupat serbe u tërhoqën nga Kosova.

### Osmani e Kurti bënë nderime te Pllaka Përkujtimore e ushtarëve të rënë të NATO-s gjatë shërbimit në Kosovë

Në vazhdën e aktiviteteve, me rastin e shënimit të 23-vjetorit të Ditës së Paqes, presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë nderime te Pllaka Përkujtimore e ushtarëve të rënë të NATO-s gjatë shërbimit në operacionin e KFOR-it në Kosovë. Duke kujtuar pranverën e vitit 1999, kryeministri Kurti tha se 19 shtete demokratike të Aleancës Veriatlantike u bënë bashkë dhe ndërhynë ushtarakisht kundër Jugosllavisë dhe Serbisë së Millosheviqit që ta ndalin gjenocidin e forcave serbe në Kosovë. “Aeroplanët e NATO-s bombarduan për 78 ditë, por më 12 qershor, sipas kryeministrit Kurti, është dita kur trupat tokësore, këmbësoria e NATO-s, u bashkëngjitet sulmeve nga ajri dhe në këtë mënyrë na bën të mundshme që për çdo vit, e sot janë bërë 23 vjet, ne ta kremtojmë 12 qershorin si Ditë të Çlirimit e të Paqes”, u shpreh kryeministri Kurti.

→



# Hovenier takon gruan simbol të eksodit të Kosovës: Sherifja, fytyra e një lufte brutale

Ishte marsi i vitit 1999, periudhë kjo e cila për popullin e Kosovës ishte tejet e rëndë. Kolona të gjata njerëzish, të rinj me çanta në duar, fëmijë që qanin, të moshuar që mezi ecnin, ia kishin mësyrë një rruge që nuk e kishin idenë se ku do t'i çonte.
Të frikësuar në çdo hap që bënin nuk e dinin as nga po shkonin, vetëm dëshironin të iknin sa më larg paramilitarëve serbë të cilët gjatë viteve 1998-99 vrisnin civilë e të pafajshëm dhe digjnin çdo gjë që kishin përpara.
Fotografi boshnjak Damir Sagolj, i cili punon për "Reuters", gjatë periudhës së luftës në Kosovë kishte shkrepur fotografi të cilat pasqyronin gjendjen reale të luftës dhe terrorin që po përjetonte popullata.
Në një fotografi të bërë nga Sagolj shihet një kolonë e gjatë banorësh të Kaçanikut, por që në fokus ka një grua me një shami të bardhë në kokë derisa mbante në gji një foshnje. Në fytyrën e saj shihen frika dhe zemërimi. Kjo grua quhet Sherife Luta. Ajo i kishte mbijetuar shumë mirë asaj kohe, ndërsa foshnja që mbante në duar, thënë më mirë vajza e saj, tani është rritur dhe në atëkohë nuk dinte asgjë çfarë po ndodhte.
Me rastin e shënimit të 23-vjetorit të çlirimit të Kosovës, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeff Hovenier, ka takuar Sherife Lutën. "Ishte kënaqësi që takova sot Sherife Lutën dhe familjen e saj në festën e Ditës së Paqes. 23 vjet më parë Sherifja u bë fytyra e një lufte brutale pasi ajo dhe fëmija i saj u larguan nga Kosova. Sot ata janë të sigurt dhe të shëndetshëm", ka shkruar Hovenier derisa në krah të djathtë të tij është Sherife Luta.






# "Open Balkan", mollë sherri për shqiptarët



**Prishtinë, 12 qershor** - Vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes marrëdhënia e ftohtë mes dy kryeministrave shqiptarë. Politikë e tyre nuk duhet të jenë pazaret ditore, thonë njohësit e çështjeve politike. "Ballkani i hapur" mund të jetë kthyer në mollë sherri për dy shtetet shqiptare.
Lidershipi kosovar dhe ai shqiptar duket të kenë hatërmbetje të mëdha për shkak të një iniciative që më shumë se karakter politik, e ka qëllimin ekonomik.
Kryeministri Edi Rama, njëjtë sikurse gjithmonë, edhe këtë herë në Ohër e konfirmoi qëndrimin e tij për "Ballkanin e hapur".
Qëndrim të palëkundshëm ka edhe kryeministri Albin Kurti.
Krejt kjo situatë nga analisti Shqiprim Pula po shihet si aktrim i panevojshëm i dy kryeministrave shqiptarë. "Nga veprimet që po i shohim, po lë të kuptohet se raportet nuk janë aq komode. Pas marrjes së mandatit të dytë, kryeministri Kurti nuk e respektoi atë traditën që kishte të bënte me vizitën e parë jashtë Kosovës dhe nuk shkoi në Tiranë. Në politikë nganjëherë duhet të aktrosh por, si duket, aktrimi nuk është i mjaftueshëm për dy kryeministrat dhe kjo po shpërfaq ftohtësinë e tyre. Nga syri i të huajve kjo mund t'i përshtatet thënies së Atë Gjergj Fishtës që 'Shqiptarët janë ashtu siç i do hasmi'", ka thënë analisti Shqiprim Pula.
Sipas njohësve të çështjeve politike, marrëdhëniet mes dy shteteve nuk duhet të jenë temat dhe pazare të politikave ditore. "Duket që ka tensione mes dy kryeministrave për shkak të dallimeve që i kanë politike por tash, si dy kryeministra që janë, duhet të kishin raporte strategjike për ta çuar kombin shqiptar më afër Bashkimit Evropian dhe Kosovën më afër NATO-s. Kosova duhet ta ndiejë kursin e vet shtetëror në integrime në BE e NATO dhe marrëdhëniet tona me Shqipërinë nuk duhet të ishin temë apo pazare ditore politike", ka thënë analisti Gazmir Raci.
Raportet mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, filluan të ftohen në vitin 2019, kur Rama se bashku me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, propozuan iniciativën "Ballkani i hapur", e që Kosova vazhdon të mos i bashkëngjitet kësaj iniciative në të cilën janë të përfshirë shtetet e Ballkanit Perëndimor./Portali D/

Ai tha se sot kujtojmë të gjithë të rënët, kujtojmë edhe ata që nuk janë në mesin tonë nga radhët e NATO-s e që kontribuuan shumë për çlirimin e vendit tonë e për lirinë e popullit tonë.
Përveç qytetarëve të Republikës dhe mbarë shqiptarët, kryeministri uroi edhe të gjithë zyrtarët e pjesëtarët e NATO-s në Kosovë dhe jashtë saj.

### Nderohet Prekazi

"Lufta çlirimtare nuk mund të kujtohet, nuk mund të mendohet dhe as nuk mund të paramendohet nga askush pa Jasharët", kështu u shpreh kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, pas homazheve në Prekaz në nderim të familjes Jashari me rastin e 12 Qershorit, Ditës së Paqes, bashkë me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, zëvendëskryeministren për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut, Emilija Rexhepi, ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe zëvendësministrin e Mbrojtjes, Shemsi Syla. "Prekazi heroik është kryeqyteti i kryengritjes shqiptare, andaj sot u themi të gjithë qytetarëve të Republikës, shqiptarëve mbarë, urime 12 Qershori, Dita e Çlirimit dhe e Paqes, e cila i ka rrënjët pikërisht këtu te sakrifica dhe flijimi i familjes së gjerë Jasharaj, me ç'rast nga 59 veta gjithsej, gjysma ishin fëmijë e gra krahë për krahë me komandantin, kryekomandantin Adem Jashari, bacën Shaban, Hamzën dhe të gjithë të tjerët aty", theksoi kryeministri Kurti, duke shtuar se: "Lavdia e tyre është e përjetshme ashtu sikurse edhe kujtimi ynë i pashlyeshëm".
Në shënimin e 12 qershorit, Osmani e Kurti kanë nderuar edhe ish-presidentin Ibrahim Rugova dhe Adem Demaçi.

### Ditën e Çlirimit e kujton edhe opozita

Me rastin e Ditës së Çlirimit, 12 Qershorit, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se falë gjakut të dëshmorëve, vendosmërisë e trimërisë së luftëtarëve të UÇK-së, intervenimit të NATO-s, sot jemi pjesë e botës së lirë. "E shenjtë është dita e lirisë së Kosovës. Falë gjakut të dëshmorëve, vendosmërisë e trimërisë së luftëtarëve të UÇK-së, intervenimit të NATO-s, sot jemi pjesë e botës së lirë. Amaneti i atyre që ranë për lirinë që e gëzojmë sot, na obligon ta ruajmë të plotë e ta zhvillojmë Kosovën! Kosovë, urime Dita e Çlirimit!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".
Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se 23 vjet më parë iu dha fund përgjithmonë robërisë e vuajtjeve shekullore të popullit tonë. "23 vjet më parë për Kosovën nisi një kohë e re, e lirisë, që i hapi rrugë ndërtimit e zhvillimit të vendit. Kështu, rindërtuam shtëpitë e djegura, shkollat e reja, rrugët e autostradat, por edhe administratën, policinë e ushtrinë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Ai ka theksuar se: "Jetësuam bashkë ëndrrën e shumë brezave për shtet e pavarësi. Për Kosovën e lirë e me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Në këtë rrugëtim u jemi falënderues përjetësisht miqve që na dolën krah, NATO-s, ShBA-së dhe shteteve të tjera demokratike".
Krasniqi ka thënë se sot përkulemi para sakrificës së shumë brezave të dëshmorëve, martirëve, të burgosurve, veprimtarëve e intelektualëve shqiptarë, që u angazhuan ditë e natë për këtë ditë.
"Nderojmë me respektin e përjetshëm luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heronjve tanë, që Kosovën e kishin më të shtrenjtën. Sot, këtë ditë të bekuar, ua urojmë edhe themeluesve të UÇK-së, Hashim Thaçit e Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit dhe çlirimtarëve të tjerë, të cilët padrejtësisht sot nuk janë pranë nesh", ka shkruar Krasniqi.
Ai ka theksuar se këto sakrifica shekullore, që po vazhdojnë edhe sot, na rikujtojnë vazhdimisht çmimin e lartë të lirisë dhe obligimin që kemi për ta çmuar e për ta ruajtur atë.

# A është strategjia e re zgjidhje për krizën energjetike?



Prishtinë, 12 qershor - Kosova ka mbi njëzet vjet që përballet me mungesë të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike dhe nivel të lartë të ndotjes nga termocentralet. Një prej arsyeve besohet të jetë vjetërsia e këtyre termocentraleve që djegin thëngjill.
Për t'i zgjidhur këto probleme dhe të tjera në fushën e sektorit të energjisë, Qeveria e Kosovës ka publikuar më 7 qershor Draftin e Strategjisë së Energjisë për vitet 2022-2031.
Në këtë dokument përcaktohen drejtimet dhe veprimet kryesore për zhvillimin e sektorit të energjisë në dekadën e ardhshme.
Për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike dhe për uljen e nivelit të ndotjes nga termocentralet, rëndësi e posaçme u jepet burimeve të ripërtërishme të energjisë.
Aktualisht, rreth 94 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga djegia e thëngjillit, ndërsa rreth 6 për qind nga burimet e ripërtërishme, si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet me diell.
Nevojat e Kosovës për energji elektrike arrijnë në ditë dimri deri në 1 300 megavat në orë.
Kapacitetet e prodhimit nga burime të ripërtërishme janë 244 megavat.
Me Draft-Strategjinë e Energjisë parashihet që këto kapacitete të arrijnë në 490 megavat në vitin 2024 dhe deri në 1 300 megavat në vitin 2031.
Ministrja e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, ka thënë se synimi është që pas dhjetë vjetësh, 35 për qind e konsumit të energjisë elektrike të gjenerohet nga burimet e ripërtërishme.
Për ish-ministrin e Energjisë, Ethem Çeku, njëherësh ekspert në këtë fushë, Draft-Strategjia e Energjisë është një dokument i domosdoshëm, por "nuk përkon me realitetin në të cilin është sektori i energjisë në Kosovë". "Ky dokument më shumë do të ishte për vendet skandinave sesa për Kosovën, sepse i gjithë koncepti i strategjisë për furnizim të qëndrueshëm me energji, për periudhën 10-vjeçare, është bazuar në energji të pastër. Në Kosovë, fatkeqësisht, është gati e pamundur të gjenden të gjitha ato resurse", thotë Çeku.
Ai shton se zhvillimi privat i burimeve të ripërtërishme të energjisë ka hasur në shumë burokraci që e kanë ngadalësuar.
As klima në Kosovë, thotë ai, nuk është në favor të këtyre burimeve. "Bazimi vetëm te energjia solare, e ujit apo e erës, do ta bënte Kosovën të varur nga tregu i jashtëm", thotë Çeku.
Nevojat e Kosovës për energji elektrike i tejkalojnë kapacitetet e prodhimit, sidomos gjatë dimrit.
Sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, në vitin 2021 janë importuar 1 311 461 megavatë rrymë.
Ambientalistët thonë se Kosova nuk ka burime të mjaftueshme për energji të ripërtërishme, por se duhet t'i zhvillojë ato. "Kosova nuk ka potencial për hidro-energji, mirëpo ka potencial për energji solare dhe të erës", thotë Egzona Shala nga organizata "EcoZ".
"Rreth 200 ditë me diell ekzistojnë mesatarisht [në vit] në Kosovë, që mund të shfrytëzohen për energji solare. Kapacitetet e erës, po ashtu, janë të mjaftueshme për gjenerim të energjisë - vetëm se varet nga sipërfaqja dhe vendi ku vendosen burimet", shton ajo.
Thëngjilli - burim i energjisë që nuk rigjenerohet - prodhon ndotje toksike kur digjet.
Bashkimi Evropian - blloku ku Kosova mëton të integrohet - ka caktuar disa afate për mbylljen graduale të termocentraleve me thëngjill meqë djegia e tij ndikon negativisht edhe në ngrohjen globale.
Me anë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Samitit të Sofjes, Kosova është zotuar se deri në vitin 2050 do të dekarbonizohet apo do ta zvogëlojë varësinë nga thëngjilli.
Shala thotë se problemi i vetëm me energjinë e ripërtërishme është ruajtja e saj por, siç shton, ka bateri që shërbejnë për këtë qëllim.
Në muajin maj Qeveria e Kosovës dhe Korporata amerikane Sfidat e Mijëvjeçarit kanë finalizuar një marrëveshje në vlerë prej më shumë se 230 milionë dollarësh - mjete këto që pritet të shfrytëzohen edhe për sigurimin e këtyre baterive.
Energjia e prodhuar nga burime të ripërtërishme akumulohet në këto bateri dhe shfrytëzohet varësisht prej nevojave.
Kosova ka më shumë se 10 miliardë tonë linjit dhe, si e tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij burimi.
Mihja e thëngjillit dhe nxjerrja e linjitit përdoren për termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" që gjenden në Obiliq.
Draft-Strategjia e Energjisë nuk parasheh ndonjë impiant të ri linjiti, por vetëm rinovimin e dy njësive të Termocentralit "Kosova B" dhe, së paku, një njësie të Termocentralit "Kosova A" deri në vitin 2024.
Sipas Çekut, kjo nuk mjafton për furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. Ai thotë se burimet natyrore është dashur të futen në funksion të zhvillimit të sektorit të energjisë. "Nëse bëhet folur se Kosova mund të bëhet shtet dhe mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm, një gjë e tillë është bazuar në pasuritë natyrore. Ku janë pasuritë natyrore të Kosovës në këtë draft-strategji? Nëse i shohim vendet e BE-së, Gjermaninë, Poloninë e të tjera, ato e kanë linjitin në përdorim si burim të domosdoshëm për momentin", thotë Çeku.
Draft-Strategjia për Energji përmend edhe gazin natyror si burim energjie. Vitin e kaluar Kosova e ka refuzuar një projekt të Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit, i cili sjell gazin nga Azerbajxhani në Greqi, për ta shpërndarë më pas edhe në vende të tjera.
Kosova ka hequr dorë nga gazsjellësi i njohur si TAP me arsyetimin se është i pafavorshëm ekonomikisht dhe i shtrenjtë.
Institucionet evropiane e mbështetin TAP-in, pasi e shohin si një mundësi reale për ta përmirësuar sigurinë energjetike dhe për t'i diversifikuar me gaz tregjet evropiane.
Sipas Draft-Strategjisë së Energjisë, përfshirja e Kosovës në këtë projekt do të bëhej përmes terminalit në Vlorë të Shqipërisë.
Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për rritjen e bashkëpunimit me Shqipërinë në sektorin energjetik.
Draft-Strategjia për Energji është nxjerrë tashmë në konsultim publik në disa komuna të Kosovës dhe më pas do të dalë në Kuvend, ku edhe duhet të miratohet.

# Kosova mes përballjes faktorizuese dhe zmbrapsjes izoluese (2)

## *"Ballkani i hapur" interes rus apo amerikan?*



Shkruan: Agron HOTI

Askush s'e shpjegon më mirë rëndësinë e Ballkanit të Hapur për rajonin e Ballkanit Perëndimor sesa deklarata e Ambasadorit Amerikan në Beograd Chrostopher Hill dhënë televizionit shqiptar Abc kur thotë: "jam këtu (në Ohër v.i.) për ta mbështetur këtë projekt, pasi besoj se "Ballkani i hapur" është një projekt origjinal bashkëpunimi dhe mjaft i vlefshëm për vendet përkatëse….Lavrov nuk është një mbështetës i "Ballkanit të hapur", ndaj deklarata e tij shpreh vullnet negativ".

E tash, nëse Ballkani i Hapur do të ishte projeksion e interes rus, si paska mundësi atëherë që SHBA të përkrahë një iniciativë ruse, kur dihet që SHBA po bën pikërisht të kundërtën e asaj që po bën Rusia në rajon. Nëse Minischengeni dje dhe Ballkani i Hapur sot na qenkan iniciativa ruse, si paska pasur mundësi që SHBA t'iu paskësh thënë po iniciativave ruse bile edhe në Shtëpi të Bardhë në vitin 2020 në kuadër të Marrëveshjes së Uashingtonit për Normalizimin e Raporteve Ekonomike Kosovë-Serbi? Pyetja: A është aq e paditur SHBA sa të nënshkruajë iniciativë ruse midis Shtëpisë së Bardhë?

Për më tepër, e njëjta Marrëveshje Uashingtonit e shtatorit 2020 midis Kosovës e Serbisë po mbështetet fuqishëm edhe nga Administrata Biden ku Ambasadori Hill dhe Gabriel Escobar iu bashkuan edhe personalisht/virtualisht Samitit të Ballkanit të Hapur në Ohër të Maqedonisë së Veriut. E tash, a thua SHBA na qenka në funksion të Rusisë? Këtë s'e beson askush, përpos manipulimeve ruse e serbe që për synim kanë përçarjen dhe rritjen e antiamerikanizmit në rajonin tonë, sidomos në hapësira shqiptare, ku ende ka prezencë të theksuar serbe e ruse sidomos mediale keqinformuese. Si na qenka SHBA në funksion të Rusisë, kur si Administrata Trump ashtu edhe ajo e Biden që sa vite po paralajmëronin rrezikun e rrëshqitjes së Evropës kah Rusia, përfshirë Ballkanin Perëndimor?

Nëse vërtet "Ballkani i hapur" do të çonte ujë në Rusi, minimumi i veprimit nga SHBA do të ishte mospjesëmarrja e Zyrtarëve të saj në iniciativa të tilla. Por, nëse kjo s'po ndodh, si paska mundësi atëherë që SHBA të na qenka në funksion të Rusisë, kur dihet tanimë që SHBA me aleatët e saj hapur po e mbështet Ukrainën, hapur po i kërkon BE-së të ndalë tregtinë dhe importin e energjisë ruse, hapur po iu kërkon vendeve të Ballkanit Perëndimor që të përkushtohen në reforma, integrim rajonal dhe BE si dhe të rreshtohen drejt politikave të BE-së kundrejt Ukrainës e jo atyre ruse siç po bën Serbia.

### Loja ruse e përvetësimit të "Ballkanit të hapur"?

Deri më tani Rusia përmes Serbisë ja ka arritur qëllimit në Kosovë, sepse Kosova sot - ashtu siç do Rusia - është e përçarë dhe e polarizuar si kurrë më parë, me islam politik në rritje anekënd Kosovës që po prodhon antiamerikanizëm dhe antiperëndim në rritje, e thyer rëndë politikisht nga brenda, pa kurrfarë konsensusi nacional për tema të mëdha dhe nën tension të vazhdueshëm me Veriun e Kosovës dhe jo vetëm, saktësisht siç ka synuar Serbia e Rusia në këto 23 vite çlirim e 14 shtetësi.

Rusia e di që Ballkani Perëndimor është i rrethuar i tëri nga NATO dhe BE dhe se në rrethana të tilla çfarëdo depërtimi ushtarak apo ekonomik rus është i pamundshëm. Rusia e di po ashtu që ka interesa të papërfillshme ekonomike në Ballkan Perëndimor, ndaj në pamundësi shtrirjeje prezence fizike të saj në rajonin tonë, e përdor Serbinë për ta destabilizuar rajonin, ashtu siç investon shumë në secilin vend të Ballkanit Perëndimor për t'i thyer shoqëritë aq shumë nga brenda sa të mos jenë në gjendje të projektojnë të ardhme, aq më pak integrim rajonal drejt BE-së.

Për fat të keq, Rusia asnjëherë s'i kishte ndalur përpjekjet për minimin e demokracisë në Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Kosovë, Shqipëri, Serbi e Bosnje e Hercegovinë. Prezenca e theksuar e soft power e Rusisë dhe Serbisë nëpër vendet e Ballkanit Perëndimor ushqen tensionet politike gjithandej rajonit duke nxitur tema përçarëse ditore për të shkaktuar demoralizim të përgjithshëm si dhe për të penguar kështu çfarëdo bashkëpunimi rajonal si kushti kryesor për të ecur drejt BE-së.

### Si po e përçan Rusia rajonin?

"Ballkanin e hapur" apo "Minischengenin" ku ulet ambasadori amerikan Hill bashkë me Gabriel Escobarin të përkrahur nga Shtëpia e Bardhë po tenton ta përvetësojë ministri i Jashtëm rus, Lavrov, vetëm për ta ekspozuar Kosovën si refuzuese të integrimit rajonal si kundërpërgjigje ndaj SHBA-së që me çdo kusht po mundohet t'i ulë bashkë të gjitha shtetet e rajonit, bile edhe duke i bllokuar hapësirën ajrore ardhjes së Lavrovit në Serbi që po vinte për t'i futur zjarrin rajonit me Serbinë si ndezëse.

Rusia, ashtu siç ja kishte dalë me sukses ta bllokonte Procesin e Berlinit përmes Serbisë që edhe sot s'e pranon nënshkrimin e Kosovës si shtet, njëjtë do ta bllokojë edhe Ballkanin e Hapur. Derisa Kosova i thotë jo "Ballkanit të hapur", Serbia e Rusia do të mundohen ta përvetësojnë këtë iniciativë për ta ekspozuar sa më shumë Kosovën si refuzuese të integrimit rajonal që është qëllimi primar ruso-serb. Sapo Kosova t'i thotë po Ballkanit të Hapur (sigurisht me kusht që të trajtohet e barabartë mes të barabartëve), e para që do të mundohet ta tërheqë Serbinë prapa do të jetë Rusia, sepse kjo e fundit nuk do që "Ballkani i hapur" të jetojë pa tensione.

Rusia përmes Serbisë - si në Procesin e Berlinit ashtu edhe në "Ballkanin e hapur" - nuk e pranon Kosovën shtet, sepse si Rusia ashtu edhe Serbia nuk janë fare të interesuara për integrimin por saktësisht për dezintegrimin e rajonit. Sepse integrimi rajonal e nxjerr prej loje Rusinë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, kurse dezintegrimi e fut në lojë Rusinë siç në fakt është duke e futur. Mospjesëmarrja e Kosovës në Ballkan të Hapur çon ujë te Rusia që pengon me çdo mjet integrimin rajonal të Ballkanit Perëndimor. ***(Vazhdon)***



# EKONOMIA | Evropën e presin disa muaj shumë të vështirë



Për shumë vëzhgues me përvojë të politikës monetare, dy deklaratat e mëposhtme janë kontradiktore. Eurozona përballet me një kërcënim të madh të një recesioni që mund të ndodhë në fund të këtij viti. Megjithatë, Banka Qendrore Evropiane duhet të anulojë mbështetjen monetare nga ekonomia e eurozonës, dhe të rrisë normat e interesit.

Për vite me radhë, për drejtuesit e bankave qendrore në Evropë, është cilësuar si përgjigja e duhur mbështetja e shpenzimeve në kohëra të vështira, nëpërmjet politikave monetare më të lirshme, si dhe marrja e çdo lloj mase që ishte e mundur për të shmangur recesionin.

Për këtë arsye, Banka Qendrore Evropiane fitoi një respekt të gjerë sidomos kur presidenti i atëhershëm i saj, Mario Dragi, u zotua para një dekade të bënte "çfarëdolloj gjëje që duhej" për të gjallëruar rritjen ekonomike në rajon. Premtimi për një mbështetje monetare të pakufizuar, i dha fund krizës së eurozonës.

Por në vitin 2022, rrethanat nuk janë shumë të ngjashme me vitin 2012, ndaj politikat duhet t'u përshtaten rrethanave të reja. Dhjetë vjet më parë, Evropa ishte e përfshirë në një mori politikash shtrënguese për të përmirësuar financat publike, papunësia në të gjithë bllokun ishte mbi 10 për qind, dhe në rritje të vazhdueshme.

Inflacioni ishte pak më shumë se 2 për qind dhe në rënie. Pra kishim të bënim me një ekonomi që kishte nevojë për stimul. Sot papunësia në të gjithë eurozonën ra në 6.8 për qind në muajt mars dhe prill 2002, pra në nivelin e vet më të ulët që nga krijimi i monedhës së përbashkët në vitin 1999. Ndërkohë inflacioni në maj arriti në 8.1 për qind.

Dhe në vend të masave shtrënguese, vendet evropiane po planifikojnë të ulin shpenzimet e tyre nën nivelin e fondin e rimëkëmbjes prej 800 miliardë eurosh. Megjithëse ngjashmëritë me një dekadë më parë janë të pakta, kjo ende nuk mjafton për të mbështetur një politikë monetare më të shtrënguar, të cilën BQE ka të ngjarë ta çojë më tej në mbledhjen e saj të radhës.

Për këtë, ne duhet të shohim më nga afër forcat që ndikojnë tek oferta dhe kërkesa në ekonominë e eurozonës, si dhe rreziqet që lidhen me ndërhyrje të ndryshme. Rritja ekonomike është ngadalësuar ndjeshëm që nga rimëkëmbja e fortë nga kriza e shkaktuar nga koronavirusi verën e kaluar.

Prodhimi i Brendshëm Bruto në të gjithë eurozonën u rrit vetëm 0.3 për qind gjatë 3-mujorit e fundit të 2021 dhe vetëm 0.2 për qind në 3-mujorin e parë të 2022, që përkoi me pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Në 3-mujorët e ardhshëm, kërkesa do të rritet për shkak të heqjes së shumicës së kufizimeve anti–Covid këtë verë, sidomos për ofruesit e shërbimeve që përballen me konsumatorët.

Por ajo do të frenohet nga rritja e kostos së jetesës për shkak të çmimeve më të larta të energjisë. Por nëse normat e rritjes mbeten të dobëta apo kthehen në shifra negative, e vërteta e hidhur është se Evropa duhet të shpenzojë më pak për gjëra të tjera, sepse si një importuese e energjisë, rritja e kostos së naftës dhe gazit i ka bërë që të gjithë më të varfër.

Nëse nuk njihet ky realitet, kërkesa do të vazhdojë ta tejkalojë ofertën, duke e shndërruar në një rritje ekonomike të përkohshme, kryesisht të çmimeve të energjisë, në një inflacion të përgjithshëm më problematik dhe të vazhdueshëm.

Kjo do të ndodhte e shoqëruar me ritme të dobëta të rritjes ekonomike, të ngjashme me ato të 3-mujorëve të fundit, apo edhe me një recesion të vogël. BQE vlerëson se barra faktike për konsumatorët për shkak të çmimeve më të larta të gazit, energjisë elektrike dhe benzinës arrin në 1.3 për qind të të ardhurave kombëtare.

Kjo është më së paku, goditja që do të pësojmë të gjithë. Ndërsa në vitin 2011, Banka Qendrore Evropiane gaboi sepse priste që inflacioni i çmimeve të energjisë dhe ushqimeve të vazhdonte në kohën e një depresioni ekonomik, gabimi më i rëndësishëm i politikës për rrethanat e sotme ndodhi në vitet 1970.

Më pas, vendet që shtypën me shpejtësi impulset inflacioniste përmes politikave monetare më të shtrënguar, me në krye Bundesbank e Gjermanisë Perëndimore, përjetuan një rënie ekonomike afatshkurtër. Rritja e çmimeve ishte të përkohshme, dhe nuk ndikoi shumë në jetën e përditshme.

Ndërkohë vendet që ndoqën një rrugë më të përshtatshme – Italia dhe Franca – do të përballeshin me norma inflacioni vazhdimisht më të larta, dhe që imponuan recesione shumë më të forta në fillim të viteve 1980, për të frenuar inflacionin e madh.

Prandaj ky është momenti i duhur për të ndërmarrë veprime të hershme, me synim parandalimin e zmadhimit të problemit që mund të shkaktojë inflacioni i lartë. Ka shenja se rritja e çmimeve po bëhet më e përhapur për mallrat dhe shërbimet në Evropë.

Në muajin prill, 3/4 e të gjitha mallrave dhe shërbimeve ishin më shumë se 2 për qind më të larta se një vit më parë, duke treguar se kompanitë janë gjithnjë e më të gatshme të rrisin çmimet në vend se të reduktojnë marzhet e tyre të fitimit. Pritshmëritë afatgjata në lidhje me inflacionin janë rritur ndjeshëm në tregjet financiare, dhe nuk janë më nën objektivin 2 për qind të BQE-së.

Me një inflacion në nivelin 8 për qind dhe me normën e interesit të BQE-së ende negative, minus 0.5 për qind, norma reale e interesit është tejet e ulët edhe me politikën më shtrënguese që po ndjek aktualisht Banka Qendrore Evropiane.

BQE-ja ka të drejtë kur paralajmëron se do të rrisë normat e interesit në korrik, dhe më pas do t'i zhvendosë ato nga niveli negativ deri në shtator. Gjendja ekonomike është e keqe. Por rreziqet do të ishin më të mëdha nëse Banka Qendrore Evropiane nuk do të bënte asgjë.

Një ekonomi e lëkundur e eurozonës, mund të nxitet sërish nga një politikë monetare më e lirshme, nëse rënia rezulton të jetë më e thellë se sa kërkohet për të mbajtur nën kontroll inflacionin. Në të kundërt, kostot e përballjes me humbjen e besimit të konsumatorit në aftësinë e autoriteteve për të kontrolluar çmimet, do të ishin tepër të mëdha.

Muajt në vazhdim do të jenë shumë të vështirë për ekonomitë evropiane. Të ardhurat do të bien, ka shumë të ngjarë të shohim një recesion, ndërsa normat e interesit duhet të rriten, gjë që do të rritë presionet mbi familjet. Situata do të jetë e vështirë. Por ky është rregullimi që duhet të bëjë çdo ekonomi evropiane, teksa po distancohemi nga energjia ruse e lirë por që në fund të fundit është më e rrezikshme. / *Chris Gilles "Financial Times"* | *bota.al*




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Kosova pëson humbje në ndeshjen e tensionuar ndaj Greqisë

